



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 83/17
Prishtinë, më 28.03.2017, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje e Komisionit për Buxhet dhe Financa morën pjesë: Naser Osmani, Jelena Bontic, Shukri Buja, Labinothë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Shqipe Pantina, Sali Morina, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka

Mungoi: Safete Hadërgjonaj.

Pjesëmarrës të ftuar: Ismet Krasniqi – Sekretar i Kuvendit, Emrush Haxhiu dhe Istret Azemi nga Administrata e Kuvendit.

Pjesëmarrsit tjerë : Sylejman Blaku (Kosova Sot), Shefki Kastrati (NDI), Pranvera Musa (Kosovapress), Uran Haxha (Koha Ditore), Albulena Mavraj (Epoka e Re), Jeta Rafuna (GPLDK), Rejhane Zylfijaj (GIZ), Sanije Berisha (OSBE), Mërgim Hoti (Praktikant), Kujtesa Shala (Praktikante).

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canoll.

Mbledhjen e kryesoi: Kryetar i Komisionit - Naser Osmani.

R e n d i i d i t ë s

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitet 2018-2020;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2016;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – propozoi që rendi i ditës të plotësohet me një pikë shtesë e katërt me radhë: Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-132 për Automjetet dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në aspektin e ndikimit buxhetor.

Në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht miratoi rendin e ditës me plotësime , shtohet pika e katërt me radhës si vijon: Shqyrtimi i Projektligjit për Automjetet dhe amendamenteve të

Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. Pika e katërt bëhet pika e pestë e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitet 2018 - 2020

Ismet Krasniqi – paraqiti një përmbledhj të shpenzimeve të Kuvendit për vitin 2016 sipas kategorive. Tek kategoria e pagave për vitin 2018 janë paraparë 500.000 euro më shumë ndërsa për vitin 2019, 900.000 euro më shumë. Në vitin 2018 përmbillet mandati 4 vjeçar i deputetëve dhe mjetet janë paraparë për mandatin pasivë të deputetëve. Tek mallrat dhe shërbimet në kuadër të KASH-it si total për vitin 2018 është 993.241 euro. Sa i përket programit të administratës për vitin 2018, i kemi 20 pozita të reja dhe parashihen 136.836 euro mjete shtesë. Në programin e stafit mbështetës politik, i kemi paraparë 30 pozita të reja, prej tyre 15 këshilltarë për grupet parlamentare dhe 15 asistentë të kryetarëve të komisioneve. Për këtë kërkohet një buxhet shtesë prej 300.000 euro. Vlenë të theksohet se varësisht prej numrit të deputetëve në grupe parlamentare, do të ketë edhe këshilltar.

Kryetari – pyeti përse të këtë çdo Komision nga një asistent ku me racionale dhe e nevojshme do të ishte të kishte nga ndonjë ekspert ose këshilltar profesional.

Ismet Krasniqi - në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve parashihet edhe 350.000 euro shtesë që ka të bëjë me sigurimet shëndetësore. Sa i përket propozimit për zëvendësimin në mes asistentëve me këshilltarë diferenca në pagesë është 32.000 euro dhe tani kërkohen 332.000 euro.

Fikrim Damka – theksoi se është në rregull të ketë këshilltarë dhe jo asistent për kryetarët e komisioneve. Po ashtu theksoi se do të duhej të ndahen mjete sa i përket diplomacisë parlamentare sa i përket grupeve të miqësisë pasi që çdo vit kemi shtim të aktiviteteve. Si grup funksional punues i kanë aprovuar të gjitha kërkesat e nevojshme lidhur me vitet 2018-2020.

Enver Hoti – sa i përket subvencioneve nuk është dakord dhe nuk do ta mbështet ndërsa sa i përket asistentëve është mirë të dihet me të vërtetë funksionalizimi si staf ?

Shqipe Pantina – theksoi se nuk pajtohet me shpenzimet për subvencioneve dhe duhet të hiqet. Nëse Kuvendi bënë projekte të caktuara ato duhet të figurohen si shpenzime por jo të futen në kategori të subvencioneve. Subvencionet duhet të planifikohen dhe menaxhohen nga Ministria e Shëndetësisë. Sa i përket shpenzimeve jashtë vendit ato duhet të jenë të arsyetueshme. Shpenzimet që realizohen jashtë vendit duhet të mbulojnë shpenzimet e fjetjes dhe ushqimit por asesi të ketë mëditje shtesë. Ndërsa punëtoritë nuk duhet të mbahen jashtë vendit por brenda Kosovës. Trajnimet duhet të jenë për stafin e administratës. Po ashtu pyeti pse ndarja e buxhetit për automjete duhet të jetë e njëjtë çdo vit dhe kërkon sqarim nëse vërtetë shpenzimet e automjeteve janë të njëjta çdoherë?

Besa Gaxherri - theksoi se edhe në mbledhjen e fundit edhe tani kërkon arsyetim shtese sa i përket subvencioneve dhe investimeve kapitale.

Salih Morina- theksoi e grupi punues sa i përket hartimit të KASH-it është dakorduar plotësisht. Sa i përket problemit të subvencioneve, edhe në grup punues ka kërkuar sqarime dhe është thënë se ekziston rregullorja që është miratuar nga Kryesia e Kuvendit dhe përderisa është e rregulluar nga Kryesia e Kuvendit atëherë nuk mundet që subvencionet të de-rregullohen pasi që se pari duhet shfuqizuar ato.

Ismet Krasniqi – sqaroi arsyet e investimit në ndërtesën e Kuvendit ku është një aktivitet vështirë i përballueshëm por i paraparë vit për vit mjetet e renovimit. Tjetër që vlenë të theksohet kemi pjesën e

aneksit, dhe të gjithë ata njerëz që e shfrytëzojnë aneksin kanë vërejtjet që xhamat nuk janë izoluar ndaj temperaturave të ulta gjatë dimrit. Problem tjetër është edhe me ujin dhe me këtë është primare që të investohet gjithë infrastruktura në aneksin e Kuvendit. Sa i përket subvencioneve aktualisht rregullohen me ligj dhe rregullore të miratuar nga Kryesia e Kuvendit. Kuvendi i Kosovës është partner me disa organizata që ndihmojnë atë dhe në pjesëmarrje deri me tani kemi shfrytëzuar ndihmat që për neve kanë qenë falas mirëpo me avancimin dhe rrjedhjen e kohës Kuvendi duhet të participim në këto lloj projektesh që janë në interes të Kuvendit. Sa i përket udhëtimeve zyrtare janë një vullnet i Kryesisë e cila pranon kërkesat që gjithëherë janë publike dhe ato realizohen në bazë të vendimeve që i merr Kryesia. Sa i përket pyetjes lidhur me veturat, ne e kemi një fond prej 24 veturave aktuale të cilat janë blerë nga viti 2001. Është një përpjekje e jona që të bëjmë ndërrimin e veturave aktuale me vetura të reja mirëpo këto shuma e planifikuara janë të përafërta. Ndërsa sa i përket trajnimeve kemi një buxhet sa i përket stafit dhe administratës, mirëpo deri me tash kemi pas edhe mbështetje nga organizatat si GIZ, USAID , etj.

Kryetari - ka një çështje në të cilin është dashur të merret një vendim dhe kjo ka të bëjë me ndërtimin një qendre të re protokollare në Blinajë, një qendër e përbashkët e qeverisë, presidencës dhe parlamentit ku janë ndarë 2 milion euro. Sa i përket qendrës në të cilën kemi filluar ndërtimin para disa viteve, fjala është për qendrën protokollare në Gërmë dhe mos përfundimi i saj mund të konsiderohet si dështim i Kuvendit dhe në asnjë mënyrë i administratës.

Besa Gaxherri - theksoi se është e vërtetë që Kuvendi ka dështuar për qendrën në Gërmë dhe kjo në Blinajë atëherë ne duhet të jemi më këmbëngulës. Sa i përket subvencioneve Kuvendi duhet të ketë programe dhe të ketë konkretisht cilat programe dhe projekte duhet të ndaj Kuvendi.

Shqipe Pantina - theksoi se është kundër subvencioneve.

Ismet Krasniqi - sa i përket projektit të Blinajës duhet ndjekur hapat praktik juridik, për shkakun se qendra protokollare Gërmia është në ngecje vendimmarrje juridike. Atëherë nëse Komisioni shpreh gatishmëri për këto mjete, ne duhet përgatitur një procedurë të hapave të procedurës juridike.

Kryetari – objekti i ri në Blinajë është krejtësisht i ndarë prej asaj ekzistuese në Gërmë dhe propozojë që ky projekt në Blinajë të përfshihet në KASH dhe të bëjmë përpjekje për sigurimin e mjeteve pasi që është i nevojshëm.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni me shtatë votat Për , asnjë kundër dhe dy abstenime, nxori këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitet 2018-2020.

3. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2016

Kryetari - theksoi se Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2016 është hartuar bazuar në ligjin e buxhetit të vitit 2016 dhe është në përputhje me rregullat financiare për raportim.

Ismet Krasniqi – shkurtimisht prezantoi shpenzimet për vitin 2016, ku në kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë shpenzuar 98,62%, mallra dhe shërbime 99.68%, shpenzime komunale 100 %, subvencione transfere 100 % dhe shpenzime kapitale 99.77%. Totali për këtë periudhë është 98,95%.

Enver Hoti – theksoi se nëse bëhet krahasimi i raportit të shpenzimeve në mes të vitit 2015-2016, tek biletat e udhëtimit janë afro 67.000 euro dallim, mëditje për udhëtime zyrtare jashtë vendit janë 50.000 euro, akomodimi gjatë udhëtimit zyrtare jashtë vendit janë afro 80.000 euro, shpenzimet me vendime të gjykatave janë mbi 8,000 euro. Për të gjitha këto kërkohet të na jepen sqarime?

Shqipe Pantina - shpreh shqetësimin lidhur me vizitat jashtë vendit, ku ndër të tjera tha nuk duhet shpenzuar para për ato pune që mund të kryhen edhe në vendin tonë. Gjithashtu shprehu shqetësimin lidhur me kilometrat e shpenzimeve të veturave zyrtare që ndoshta janë keqmenaxhuar apo shfrytëzuar joracionalisht. Çështja tjetër është tek subvencionet dhe transferet, ndonëse sëmundja është diçka natyrore dhe secilit duhet uruar shërim, por është krejtësisht e papranueshme që Kuvendi të ndaj subvencione për shërim të deputetëve, ku në anën tjetër ka shumë qytetar që kanë nevojë dhe nuk i kanë mundësitë e tilla të financimit të shërimit jashtë vendit.

Besa Gaxheri – në bazë të të dhënave të materialet edhe pse e kemi pranuar vonë, shohim se janë rritur shpenzimet në roaming dhe telefoninë mobile dhe fikse që në total janë 120.000 euro. Shpreh shqetësimin edhe sa i përket shpenzimeve të naftës, dhe përse në vitin e kaluar nuk ka pasur shpenzime ndërsa përse në këtë vit duhet shpenzuar 23.000 euro? Ndërsa sa i përket mirëmbajtjes së automjeteve, ndonëse shpenzimet janë të mëdha problemi i udhëtimit me vetura të Kuvendit është i pasigurt dhe i rrezikshëm, siç ishte edhe rasti i udhëtimit në Shqipëri ku kam kërkuar përgjegjësi dhe prapë kërkojë dhe nuk kam marrë një përgjigje për incidentin e ndodhur?

Shukri Buja - theksoi se nëse subvencionet shpenzohen në bazë të Rregulloreve ekzistuese nuk ka përse ti bëjmë si çështje politike dhe madje janë të nevojshme pasi që nëse llogarisim vetëm në ato subvencione të Ministrisë së Shëndetësisë, procedurat ligjore janë të gjata dhe nevoja për të financuar shërbimin për shërim nuk pret.

Kryetari – është e rëndësishme që raporti nuk përmban tejkallime, ndërsa shpenzimet në vet i kemi lejuar me rastin e miratimit të buxhetit.

Ismet Krasniqi – sqaroi se asnjë shpenzim nuk është që nuk është mbuluar me ndonjë vendim. Të gjitha vendimet janë të mbështetura në akte juridike.

Enver Hoti – për cilat vendime është fjala është e nevojshme të dihet arsyeshmëria e vendimeve?

Ismet Krasniqi - arsyeshmëria e vendimeve nuk është përgjegjësi e administratës dhe të gjitha vendimmarrjet janë të mbështetura në akte juridike, ligje dhe rregullore dhe të gjitha janë të ndërrmarra në Kryesi ku ka një transkript dhe një procesverbal. Sa i përket ndërtimit të shtëpive është vendim i seancës plenare që në me rastin e shenjtërimit të Nënë Terezës me i nda 20.000 euro për ndërtimin e një shpie. Sa i përket veturave e kemi evidencimin e shpenzimeve dhe ne jemi duke provuar me bë rigjenerimin e tyre, në mirëmbajtje dhe shpenzime tjera. Sa i përket naftës, kemi një rezervuar me 300.000 litra dhe në mënyrë suksesive përdorim edhe ngrohjen e qytetit prej orës 6-20 në mëbrëmje dhe ngrohje me rryme. Ndërkaq prej orës 8-16 në përdorim ngrohje alternative. Sa i përket shpenzimeve të informimit fjala është për blerjet e gazetave zyrtare. Gjithashtu kemi sistemin e monitorimit kundër zjarrit si dhe pajisjet tjera në kuadër të shumës së paraparë.

Pas përfundimit të diskutimeve kryetari konstatoi se Komisioni me shtatë votat Për , asnjë kundër dhe dy abstenime, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2016.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Automjetet dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetari – Projektligji përmban një kosto shtesë që ka të bëjë me kontrollin mobil të automjeteve, por që mendojë se është e përballueshme për buxhetin e Kosovës. Ajo që është problematike është amendamenti 32 ku parashihet që importimi i veturave të kufizohet në 10 vite. Unë propozoj që të bëjmë një amendament që amendamenti 32 i komisionit funksional të hyjë në fuqi me 1 janar 2018, pasi që siç është propozuar do të ndikonte në të hyrat buxhetore për këtë vit, ku janë bërë planifikimet buxhetore duke llogaritur në të hyrat nga tatimi i akcizave të veturave mbi dhjetë vjetë.

Në bazët të propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-132 për Automjetet, përmban kosto të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për Projektligjin nr. 05/L-132 për Automjetet, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, më përjashtim të amendamentit 32.
3. Komisioni, propozon amendamentin me tekstin si vijon:

Amendamenti 1

Në nenin 123, pas paragrafit 2, shtohet paragrafi i ri 3 me tekstin si vijon:

3. Neni me titull “Kushtet e importit të mjeteve rrugore”, hyn në fuqi më 1 janar 2018.

5. Të ndryshme

Kryetari – theksoi se ne jemi dakorduar në punëtorinë e mbajtur me 24.02.2017, që të mos raportojmë në Kuvend për raportet vjetore financiare të institucioneve dhe agjencive të pavarura, për të cilat Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk është komision funksional. Prandaj, propozoj që të dërgojmë Kryetarit të Kuvendit dhe një njoftim për vendimin e Komisionit për këtë çështje, që mos të ngarkohemi për këto raporte për raportim në Kuvend.

Në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që të dërgojë njoftim Kryetarit të Kuvendit dhe kryetarëve të komisioneve funksionale, në bazë të së cilit, Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk do të raportojë në Kuvend lidhur me raportet vjetore financiare të institucioneve, agjencive dhe organeve të pavarura, për të cilat nuk është komision funksional.

Mbledhja përfundoi në ora 12:15

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani